



Trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë

# **Informata mbi aktivitetet e Trupit bashkërendues**

(janar-dhjetor 2011)

Në përputhshmëri me prioritetet dhe qëllimet e definuara, trupi Koordinues i Qeveris së Republikës Sërbis për komunat e Preshevës , Bujanocit dhe Medvegjës ka arritur suksese të mjaftueshme në vitin 2011:

**a) Në fushën politike** – Është shënuar dyvjetori i nënshkrimit të marrveshjes për rindërtimin e trupit Koordinues me të cilën përfaqsesit shqiptar përsëri janë kyqur në punën e këtij organi të Qeveris, me anë të së cilës është mundësuar përfaqsimi i shqiptarve nëpër organet shtetërore.

**b) Në fushën e ekonomis** – Është organizuar mbledhje me sipërmarrsit nga Bujanoci dhe Presheva dhe me përfaqsesit e Ministris ekonomis dhe zhvillimit regjional së bashku me Fondin për zhvillim me qëllim të informimit rreth mundësive për marrjen e mjeteve të pakthyeshme dhe mënyrën e konkurimit për kredi nga Fondi për zhvillim. Jan shpallur konkurse për punë në institucionet shtetërore për pjestarët e bashkësis shqiptare.

**c) Në fushën e investimeve në infrastrukturë** – Me qëllim të forcimit të ekonomis në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, trupi Koordinues në vitin 2011 ne projektet infrastrukturore ka investuar 232.855.683,00 dinar.

Në komunën e Preshevës janë investuar 104.059.817,00 dinar për asfaltimin dhe riparimin e rrugëve në lagjën Stacioni hekurudhor dhe fshatrat Rahovic, Norçë dhe Miratoc, asfaltimin e rrugve lokale Zhunic-Bushtran, Miratoc-Cakanoc, rindërtimin e rrugës „Vllezrit Frashri”, rregullimin e koritës së lumit në fshatin Rainc, adaptimin e shtëpis së kulturës „Abdulla Krashnica” për nevojat e RTV Presheva dhe fakultetit, si dhe në fazën e dytë të punimeve në shkollën e mesme teknike “Presheva”, ndërtimin e sallës për aktivitete sportive në gjimnazin “Skenderbeu”, për vazhdimin e kanalizimit në komunën e Preshevës dhe përmirsimin e furnizimit me rrym në fshatin Cukarkë.

Në komunën e Bujanocit janë investuar 87.996.510,00 dinar për asfaltimin e rrugve në fshatin Konqul (nga rruga magjistrale deri tek shkolla), Kushtunicë, Rakovc dhe Baralevc, rrugve lokale Nesalc-Vërban, R125B Breznic e Epërme – Breznic e Poshtme, asfaltimin e trotuarve në Bujanoc, vazhdimin e ndërtimit të shkollës së mesme teknike “Sezai Surroi” (blloku c), ndërtimin e oborrit të shkollës fillore “Desanka Maksimoviq” në Samolic, renovimin e shkollës “Muharrem Kadriu” në Tërnocin e Madh dhe renovimin e katit të parë dhe ndërtimin e mobilierisë në shkollën “Naim Frashëri”, renovimin e shtëpis së kulturës për nevojat e paralelës së Fakultetit Ekonomik, ndërtimin e kanalizimit në fshatin Bozhinjevc, vazhdimin e ndërtimit të ujsjellsit në fshatin Letovic dhe Gramadë, si dhe për barsimin artificial të lopve.

Në komunën e Medvegjës janë investuar 38.100.000,00 dinar për ndërtimin e rrugve lokale Petrile-Mrkonje, Petrile-Cokotin, Cucki breg-MZ Retkocer, Reka-Miskiçi, MZ Retkocer-Vujovic, Bukiq, për mirmbajtjen e rrugve, ndërtimin e rrugës “Mariçi” në Medvegjë dhe “rrugën e Sveti ilis” në banjën e Sjarinës, mirmbajtjen e rrugve nëpër bashkis lokale në komunën e Medvegjës, rehabilitimin e rrëshqitjes së dheut në rrugën lokale Meda- Retkocer si dhe punimet në rindërtimin e parketit të sallës sportit.

Është arritur marrveshje për ndërtimin e maternitetit në ndërtesën e shtëpis së shëndetit në Preshevë dhe ka filluar procesi për adaptimin e një pjese.

**d) Në fushën e integritimeve** – Trupi Koordinues ka shpallur tre konkurse për ndarjen e mjeteve për projektet e shoqris civile. Komisionin për ndarjen e mjeteve e përbëjnë nga një përfaqses i secilës komun dhe tre përfaqses të trupit Koordinues. Trupi Koordinues në vitin 2011 për projekte të OJQ-ve ka ndar 13.723.027,00 dinar. Ka financuar gjithsej 27 projekte.

Me iniciativë të trupit Koordinues, në korrik të vitit 2010, Qeveria e Republikës Sërbis ka marr vendim për ndryshimin e vendimit rreth numrit maksimal të të punsuarve në organet shtetërore, agjensioneve publike, dhe organizatave për sigurime të patjetërsushme sociale, me anë të së cilës është mundësuar rritja e numrit të punsuarve në organet e lartpërmendura në Preshev, Bujanoc dhe Medvegj. Pas shpalljes së konkurseve janë plotësuar vendet e reja të punës në Doganë (me anë të dy konkurseve janë pranuar 24 puntor); në administratën Tatimore (pas shpalljes së katër konkurseve janë punësuar 9 puntor); Ministrin e mjedisit, minierave dhe planifikimit hapsinor (1 vend i punës). Ministria e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal ka hapur konkurs. Zbatimi i procesit të zgjedhjes pritet të bëhet në janar të vitit 2012. Ministrin tjerë në vitin 2012 do të harmonizojn Rregulloren rreth sistematizimit të vendeve të punës dhe parashikojn vendet e lira të punës për të cilët poashtu do të hapen konkurse.

Ministria e punëve të brendshme në mars ka hapur konkurs për 50 vende të reja të punës - prej të cilëve 10 vende të punës për stacionin policor Leskoc dhe 40 për atë në Vrajë (Bujanoc 20 vende të punës, preshev 20, dhe medvegjë 10). Me vendimin e ministrit të punëve të brendshme 21 kandidat kanë kaluar procesin e përzgjedhjes. Tetëmbëdhjet kandidatët e zgjedhur kanë filluar trajnimin fillestar policor në tetor, ndërsa për tre kandidatët tjerë, trupi Koordinues ka organizuar kursin në gjuhën serbe i cili do të zgjas tre muaj. Këta tre kandidat trajnimin do të fillojnë në janar të vitit 2012.

Duke i'u faleminderuar përkrahjes së ambasadës Britaneze është mundësuar programi katërmujor për praktikantët shqiptarë të cilët kanë përfituar eksperiencën të reja të punës në zyrën e trupit Koordinues në Beograd.

Trupi Koordinues ka përgaditur dy broshura për qytetarët e këtyre komunave. Në mënyrë që sa më mir të përgaditen dhe dorzohen dokumentacionet adekuate me rastin e konkurimit për punë në institucionet shtetërore, trupi Koordinues ka formuluar broshurën duke përshkruar në mënyrë detajore procesin e konkurimit. Përveç kësaj, trupi Koordinues ka konsoliduar informata të numërta në broshurë të cilët informojn qytetarët rreth azilit. Broshura është punuar në bashkëpunim me Ministrin e punëve të brendshme të Republikës Sërbis dhe Ministrin për të drejtat e njeriut dhe pakicave, administratës shtetërore dhe vetqeverisjes lokale.

**e) Në fushën e arsimit** – Trupi Koordinues ka siguruar bursa për studim në Univerzitetin e Novi Sadit për të rinjtë nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës.

Trupi Koordinues dhe Këshilli Nacional i Shqiptarëve në këtë periudhë kanë vazhduar bashkëpunimin e suksesshëm në zgjidhjen e problemeve në arsimin.

Është hapur paralelja e fakultetit Ekonomik nga Subotica në Bujanoc, që paraqet një hap të rëndësishëm për integrimin e pakicave nacionale në prirjet sociale.

Në bashkëpunim me Këshillin Nacional të Shqiptarëve, ambasadën e Republikës Shqiptare dhe Ministrin e arsimit dhe shkencave, trupi Koordinues ka mundësuar që nxënësit fillestar nga bashkësia shqiptare të marrin 1000 abetare falas në gjuhën shqipe.

Është formuar grupi i punës për zgjidhjen e problemeve të teksteve në gjuhë shqipe. Grupin e punës e përbëjnë përfaqësuesit e Ministris arsimit dhe shkencës, Trupit Koordinues, Këshillit nacional të Shqiptarëve, përfaqësuesit e Institutit për tekste dhe botues privat, Instituti për zhvillimin (përparimin) e arsimit dhe edukimit si dhe Këshilli nacional arsimor. Grupa punuese ka punuar në zgjidhjen e problemeve rreth teksteve për nxënësit e katër klasave të para të shkollës fillore, dhe duke iu

faleminderuar kësaj grupe të punës numri i madh i teksteve është siguruar për nxënësit prej klasës së par deri në të katërtën të shkollave fillore.

Për 36 student të cilët kanë regjistruar vitin e dit të studimeve në paralelen e Fakulteti Ekonomik dhe Juridik në fakultetin në Medvegj, trupi Koordinues ka siguruar bursa në shumë prej 252.000,00 dinar.

Për her të tret trupi Koordinues ndan bursa për nxënësit e shkollave të mesme të tri komunave. Në vitin 2011 trupi Koordinues ka ndar 233 bursa, 27 më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Trupi Koordinues do të mundohet që numri i nxënësve të cilët marrin burs të rritet në vitin 2012.

Trupi Koordinues edhe këtë vit ka siguruar mjete shkollore për 1200 nxënës fillestar nga komuna e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.

**f) Në mardhëniet ndërkombtare** – Zyrja e komesarit të Lart për pakica nga Haga (OSBE), zyrja e misionit të OSBE-së në Sërbi dhe ambasada e Britanis posacërisht kanë mbështetur punën e grupeve të Vecanta të punës për sigurimin e kushteve për hapjen e paraleles për arsimim të lart në Bujanoc dhe Preshev dhe vështirsit e trupit Koordinues në këtë fushë.

Ka vazhduar bashkëpunimi me programin PBILD të cilën e implemtojnë agjensione të ndryshme të kombeve të bashkuara. PBILD-i, trupit Koordinues i ka lejuar mjete për trajnimin e të punuarve në temën e krijimit të politikave kulturore dhe arsimore. Duke iu faleminderuar mjeteve të këtij programi, trupi Koordinues ka organizuar trajnime edhe për përfaqësuesit e sektorit joqeveritar nga tri komunat e jugut të Sërbisë dhe janë siguruar mjete për financimin e organizatave joqeveritare në sferën e kulturës, arsimit, drejtave të pakicave dhe gjinive. PBILD-i poashtu ka lejuar mjete trupit Koordinues të cilët janë investuar në përgaditjen e kabineteve kompjuterike në paralelen e fakultetit Ekonomik në Bujanoc.

Координационо тело и ЕУ Прогрес програм развили су сарадњу 2011. године. ЕУ Прогрес програм је Координационом телу обезбедио средства за организацију стратешког планирања и осмишљавање активности за наредну годину.

**g) Në komunikimin me publikun** – Në fillim të vitit kryetari i trupit Koordinues Millan Marković iu është drejtuar të gjithë banorve të komunës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me anë të një letre me anë të së cilës në gjuhën e tyre amtare ka njoftuar me aktivitetet dhe rezultatet e punës së trupit Koordinues. Ministri Marković qytetarve të tri komunave për her të dyt iu është drejtuar me anë të letrës në mënyrë që ata t'i informoj dhe përmend rezultatet më të rëndësishme të trupit Koordinues për vitin 2011.

Trupi Koordinues në mënyrë të vazhdueshme informon publikun rreth punës së vet duke publikuar raporte dhe tekste në veb faqen e trupit Koordinues ([www.kt.gov.rs](http://www.kt.gov.rs)), dërgon raporte rreth punës Qeveris së Republikës Sërbisë, medimeve dhe partnerve ndërkombtar.

## Aktivitetet kryesore të Trupit koordinues në periudhën e kaluar janë paraqitur në mënyrë kronologjike:

- **Bursa për studim në Novi Sad** - Në përputhsmëri me qëllimet e caktuara dhe prioritetet e trupit



Koordinues e cila gjithnjë e më shumë fokusohet në punën me të rinjët, në fillim të vitit është shpallur konkurs për dhënjën e bursave të rinjvë nga Bujanoci dhe Presheva të cilët dëshirojnë të studiojnë në fakultetet e Univerzitetit të Novi Sadit. Në mënyrë që sa më shumë të rinj të jenë të informuar rreth këtij aktiviteti të ri, trupi Koordinues ka përgaditur informatorë në gjuhën shqipe dhe serbe në të cilët janë përfshirë të gjitha informatat e rëndësishme në lidhje me kushtet e marrjes së bursave. Në të njëjtën kohë, trupi Koordinues ka organizuar takime me nxënësit dhe prindrit

në Preshevë dhe Bujanoc dhe ka përgaditur kampanjën mediatike në mënyrë që të gjithë nga mosha 18 – 22 vjeqare të kenë mundësi të informohen rreth kushteve për fitimin e bursës.

Në bashkëpunim me qeverinë e krahinës së Vojvodinës, sekretariatit krahinor për arsim, rektoratin e Univerzitetit të Novi Sadit, trupi Koordinues ka organizuar vizitë për nxënësit e shkollës së mesme nga Bujanoci dhe Presheva, dhe prindrit e tyre, vizitë kjo kushtuar Novi Sadit. Në mënyrë që të njoftohen me qytetin, Univerzitetin, si dhe të pisen me informacione rreth kushteve të studimit, është organizuar vizitë dy ditore Novi Sadit për 88 të rinj nga jugu i Serbisë. Mirëseardhje i kanë dëshiruar Kryetari i Qeverisë krahinore të Vojvodinës Bojan Pajtiq, Kryetari i trupit Koordinues Ministri Millan Marković dhe sekretari krahinor për arsim Zoltan Jegesh.

Në konkursin për bursa janë paraqitur 23 të rinj nga Bujanoci dhe Presheva. Komisioni për ndarjen e bursave ka lejuar 13 bursa për nxënësit nga Presheva dhe Bujanoci, prej të cilëve 6 serbë dhe 7 shqiptarë. Për të gjithë ata që gjuhë serbe nuk është gjuhë amtare, trupi Koordinues ka organizuar kurs intenziv tremujor të gjuhës serbe.

Në fund të qershorit të gjithë nxënësit të cilët kanë fituar bursë i'u janë nënshtruar provimit pranues në fakultetet e Univerzitetit të Novi Sadit, ndërsa njëmbëdhjetë prej tyre kanë kaluar provimin pranues dhe janë pranuar të studiojnë në fakultetet e vetzgjedhura edhe atë si student në buxhet.

Ky projekt është realizuar me mbështetjen e qeverisë krahinore të Vojvodinës, Sekretariatit krahinor për arsim, dhe pakicës dhe Rektoratit të Univerzitetit të Novi Sadit. Këtë iniciativë të trupit Koordinues ka përkrahur edhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

- **Shënimi i dyvjetorit nga nënshkrimi i Marrveshjes rreth rindërtimit të parimeve të trupit Koordinues** – Me mbledhje solemne të kryesisë së trupit Koordinues më 28.03.2011 është shënuar dyvjetori i rindërtimit të punës së këtij organi shtetror, nënshkrimi i marrveshjes së një rëndësie të madhe për komunat e jugut të Serbisë sepse me këtë marrveshje përfaqësuesit shqiptarë përsëri janë kyqur në punën e trupit Koordinues.

Përveq kryetarit të trupit Koordinues ministrit Millan Marković dhe antarëve të kryesisë së trupit Koordinues, në këtë mbledhje solemne morrën pjesë edhe zëvendëskryeministri njëkohsisht ministri i punëve të mbrendshme Ivica Daciq, ministri i ekonomisë dhe zhvillimit regjional Nebojša Ciriq, ndihmësi i ministrit të arsimit dhe shkencës Zoran Kostiq, drejtori i doganës Predrag Petronijević, drejtori

i administratës tatimore Dragutin Radosavleviq, drejtori i agjencionit për privatizim Vlladan Cvetkoviç dhe drejtori i administratës për të drejtat e njeriut dhe pakicave Nenad Gjurgjeviç.

Në mbledhje kanë marr pjes edhe partnerët ndërkombtar të cilët mbështesin punën e trupit Koordinues, shefi i misionit të OSBE-së Dimitrios Kipreos, shefi i delegacionit të Unionit Europian në Sërbë Vensan Dezher, ambasadorja e SHBA-ve Meri Vorllik, ambasadori i Britanis së Madhe Majkëll Devenport dhe koordinatori i përjetshëm i Kombeve të Bashkuara Villiam Infante.

• **Ndarja e mjeteve në konkurs të trupit Koordinues** – Trupi Koordinues në mars ka shpallur konkurs për realizimin e projekteve të organizatave joqeveritare në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Në konkurs kanë arritur 49 projekte, ndërsa shuma prej 5.461.815,00 dinarë i ka dhënë mbështetjen 10 projekteve për realizim. Mjetet janë ndarë për projekte në fushën e ekologjis, arsimimit (kurse të gjuhës serbe në Bujanoc dhe Preshevë), kyçjen e fëmijëve romë në sistemin e obligueshëm parashkollor, organizimin e ndodhive kulturore dhe puntorive që kanë të bëjnë me gazetari për të rinjtë.

• **Kursi i gjuhës Serbe** – Në konkursin e trupit Koordinues dy organizata, një nga Bujanoci dhe tjetra nga Presheva kanë organizuar kurse për mësimin e gjuhës shqipe.



„International Human Center“ nga Presheva ka organizuar kurs në gjuhën serbe për nxënësit e shkollave të mesme në komunën e Preshevës. 90 pjesëmarrësit e ndarë në dy grupe nga 45 pjesëmarrës, kanë vijuar kursin e gjuhës serbe çdo vikend në periudhë prej tre muajve. Ligjeratat janë mbajtur në hapsirat e shtëpisë së kulturës „Abdulla Krashnica“. Kryetari i trupit Koordinues ministri Millan Markoviç në fund të muajit maj i ka ndarë diploma pjesëmarrësve të këtij kursi.

„Qendra për tolerancë dhe integrim të jugut të Sërbisë“ për 30 të rinjë nga Bujanoci ka organizuar kurs të gjuhës serbe me periudhë prej tre muajve. Mësimi i gjuhës është mbështetur në ligjerata interaktive. Pas kursit fillestar të gjuhës serbe, pjesëmarrësit kanë arritur përmirësime të dukshme në komunikim dhe situata të përditshme. Pjesëmarrësit patën mundësi që diturin e fituar ta shëndrrojnë në praktikë në institucione të ndryshme në Bujanoc.

Numër i madh i të rinjëve nga Bujanoci dhe Presheva të interesuar të mësojnë gjuhën serbe është argument i arsyetimit sa i përket organizimit të këtyre aktiviteteve. Kjo është njëkohsisht edhe tregues i dëshirës për integrim në shoqëri.

• **Leksikoni juridik shqiptaro-serb** – Në fund të muajit mars në fakultetin Juridik në Nish është mbajtur promovimi i leksikonit ligjor shqiptaro-serb. Duke iu faleminderuar këtij leksikoni do të përparojë kualiteti i mbajtjes së ligjeratave në fakultetin Juridik në Medvegjë, ndërsa padyshim kjo do të i ndihmojë edhe gjyqtarëve dhe prokurorëve të njësisë gjyqësore, prokuroris dhe gjyqit në Bujanoc dhe Preshevë.

Në promovimin e këtij leksikoni mori pjesë kryetari i trupit Koordinues ministri Millan Markoviç dhe ministresha e drejtis Snezhana Malloviç. Realizimin e këtij leksikoni e ka financuar trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës Sërbisë për komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.



• **Trajnimi në Subotic** – Në fillim të muajit prill trupi Koordinues ka organizuar trajnim katër ditor në Subotic për të punuarit, pjesmarrsit e këshillit Nacional të Shqiptarve dhe komunën e Bujanocit dhe Preshevës. Trajnimi është organizuar me qëllim të përgaditjeve dhe përparimit në fushën e politikave kulturore dhe arsimore. Ky program u organizua në kuadër të programit PBILD, program i kombeve të bashkuara.

• **Mbledhje me sipërmarrsit nga Bujanoci dhe Presheva** – Trupi Koordinues në gjysmën e muajit prill ka organizuar mbledhje në mes sipërmarrsive nga Presheva dhe Bujanoci me përfaqësuesit e Ministris ekonomis dhe zhvillimit rajonal dhe Fondit për zhvillim. Sekretarja shtetërore në kuadër të Ministris ekonomis dhe zhvillimit rajonal Dragijana Radonjiq-Petroviq dhe drejtoresha e Fondit për zhvillim Sllagjana Backoviq deklaruan se qëllimi i qëndrimit të tyre është që sipërmarrsit nga jugu i Sërbisë të interesohen dhe njoftohen me procedurën e marrjes së kredive pa kthim nga Ministria e ekonomisë, e poashtu edhe nga Fondi.

Ministria e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal ka planifikuar që sipërmarrjet e suksesshme këtë vit t'i ndihmoj me 193 milion dinar, mjete të pakthyeshme. Dragijana Radonjiq-Petroviq deklaroi se Ministria e ekonomisë dhe zhvillimit rajonal po kërkon zgjidhje për zvoglimin e tatimeve dhe kontributeve në rroga, në mënyrë që të lehtësoj punën e sipërmarrsve.

• **Fëmijët nga Bujanoci për vizitë në Beograd** – Basketbollistët më të rinj të KB BSK „Junior“



nga Bujanoci, të moshës nga gjashtë deri në dhjetë vjet, në mes të muajit prill kanë vizituar dhe kanë marrë pjesë në sallën e sporteve në Beogradin e ri në një trening të ekipit junior të klubit Partizan. Pas trajnimit me Partizanët e rinjë, junior bujanocas kanë vizituar dy stadione të klubeve futbolistike, atë të „Crvena Zvezda“ dhe Partizanit duke vizituar edhe sallat e trofeve të këtyre dy klubeve më të mëdha. Gjatë vizitës në stadione të këtyre klubeve, fëmijët u shoqruan me ish basketbollistin e famshëm të Partizanit Zoran Stevanović. Masditën, të rinjtë e kaluan në restorantin

e Mc Donalds-it në shoqëri të kryetarit të trupit Koordinues, ministrit Millan Marković. Në fund të ditës, të stërbushur me ndodhi që të rinjtë bujanocas i bëri të marrin me vete momentet më të bukura, ata vizituan edhe kopshtin zoologjik.

KB BSK junior, në muajin maj ka organizuar turnir në mini basket për basketbollistët më të rinj, të cilën e hapi kryetari i trupit Koordinues ministri Millan Marković. Ai deklaroi se pjesmarrja dhe shoqrimi nëpër këso lloj aktivitetesh janë sendet më të rëndësishme, ndërsa rezultat janë në plan të dytë. Kështu që të gjithë pjesmarrsit në një mënyrë u shpallën fitues të këtij turniri, pasi që ministri Marković së bashku me përfaqësuesit e komunës Bujanocit dhe me projektin ndërkombëtar Eu Progres, kapitenave të ekipeve iu dhuroi peharë (kupa).

Vizita Beogradit dhe turniri në mini basket janë organizuar në kuadër të projektit „S' bashku të jetojmë më mirë“ të cilin e ka mbështetur trupi Koordinues i Qeverisë së Republikës Sërbisë për komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe projekti EU Progres.

• **Është hapur qendra për të rinjë** – Kryetari i trupit Koordinues ministri Millan Markoviq në fund të muajit maj ka hapur qendrën e cila i dedikohet të rinjve. Qendra gjendet në ndërtesën e komunës së Bujanocit në hapsirat e Press qendrës së trupit Koordinues.

Ministri Markoviq deklaroi se në përputhshmëri me prioritetet, trupi Koordinues ka hapur një hapsirë e cila u dedikohet të rinjve në të cilën mund të ndihen të lirë, të shoqrohen dhe të bëhen kreativ, të organizojnë dhe planifikojnë projekte dhe aktivitete të tyre.

Qendra është në dispozicion edhe të organizatave joqeveritare të cilët dëshirojnë të punojnë me të rinj, të organizojnë puntori dhe seminare, mirpo edhe përdoruesve të qendrës të i shpalosin aktivitetet e tyre e poashtu të mundohen t'i kyqin në këto aktivitete.

• **Ndarja e mjeteve në konkurs të trupit Koordinues** – Trupi Koordinues në korrik ka shpallur konkurs për realizimin e projekteve të OJQ-ve në Preshev, Bujanoc dhe Medvegj. Mjetet me shumë prej 4.316.130,00 dinarë i'u janë lejuar 7 projekteve. Janë ndarë mjete projekteve të cilat mirren me ekologji dhe mbrojtjen e ambientit, përforcimin e aftësive të caktuara tek të rinjtë dhe kyqjen e tyre në zgjidhjen konkrete të problemeve në vendet ku ata jetojnë.

• **Trajnim për OJQ-të dhe finansimi i projekteve të tyre** – Në partneritet me programin PBILD



të Kombeve të Bashkuara, trupi Koordinues ka organizuar në javën e parë të muajit qershor trajnim katër ditor për përfaqësuesit e organizatave joqeveritare. Të fokusuar kanë qenë ato organizata të cilët mirren me zgjidhjen dhe adresimin e problemeve të rinjve.

Trajnimit ka pas për qëllim përforcimin e kapaciteteve dhe përparimin në sferën e njohurisë tek organizatat e reja në sferën e kulturës dhe arsimimit, të drejtave për pakicat dhe ato gjinore. Një pjesë e këtij trajnimit iu është kushtuar edhe

temave sikur rroli në ekip, puna ekipore.

Trupi Koordinues dhe PBILD në korrik kanë shpallur konkurs për organizatat joqeveritare për ndarjen e mjeteve për projekte të vogla që të nxisin organizatat të bëjnë projekte nga politika arsimore dhe kulturore ose projekte që mirren me të drejtat e pakicave dhe gjinive.

Me këtë konkurs është përkrahur organizata „Ekoloshko drushtvo“ nga Bujanoci e cila ka mbledhur nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me qëllim që njohuritë për ekologji në komunën e Bujanocit të zhvillohen tek banorët më të rinjë të kësaj komune. Realizimi i projektit është shënuar me panairin e punimeve të nxënësve në temën e ekologjis.

• **Përkrahje studentve në Medvegj** – Të gjithë studentve të cilët kanë regjistruar vitin e dytë të studimeve në fakultetin Ekonomik dhe Juridik të univerzitetit të Nishit, paralelja në Medvegj, trupi Koordinues i ka ndarë bursa të shkurta me vlerë prej 7.000,00 dinarë. Këtë bursë e kanë marrë 36 studentë edhe atë 12 nga fakulteti Ekonomik dhe 24 nga fakulteti Juridik.



- **Abetarja për nxënësit e komunitetit shqiptarë** – Kryetari i Trupit koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës ministri Millan Marković ambasadori i Republikës së Shqipërisë Shpëtim Caushi, shefi i misionit të OSBE-së Dimtros Kipreos dhe kryetari i Këshillit nacional të shqiptarëve Galip Beqiri dje në Bujanoc prezentuan abetarën për nxënësit e komunitetit shqiptarë.



Abetarja dhe fletorja e punës janë rezultat i përpjekjeve të Këshillit kombëtarë shqiptarë që fëmijëve ti sigurohen tekstet shkollore në gjuhën amëtare, e cila është arritur me bashkpunimin e shkëlqyeshëm me Trupin Koordinues, ambasadën e Republikës së Shqipërisë dhe misionin e OSBE-së. Ky është fillimi i zgjidhjes sistematike të teksteve shkollore në gjuhën shqipe.

Ministri Millan Marković tha se përdorimi i abetares dhe fletorës së punës janë në përputhje me ligjin mbi tekstet shkollore të Republikës së Serbisë. Sipas fjalëve të tij, ky tekst shkollorë është importuar nga Shqipëria me miratimin e Ministrisë së arsimit dhe shkencave me rekomandimin të Këshillit nacional të shqiptarë është shtypur në Serbi.

Ministri Millan Marković, shefi i misionit të OSBE-së Dimitros Kipreos, ambasadori Shpëtim Caushi dhe kryetari i Këshillit nacional shqiptarë Galip Beqiri vizituan klasën e parë të shkollës fillore Naim Frashëri ku edhe i shpërndanë abetarët dhe fletoret e punës.

- **Programi për praktikant në organet shtetore të Republikës Serbis** – Dhjet të rinjë shqiptar, romë dhe boshnjak do të kalojnë gjashtë muaj duke mbajtur praktikë në organet shtetore të Republikës Serbis në të cilët prej nëntorit 2011 deri në prill të vitit 2012 do të arrijn të formojn pasqyrë në mënyrën e marrjes së vendimeve dhe funksionimin e administratës shtetore. Programi për praktikant realizohet në trupin Koordinues të Qeverisë së Republikës Serbis për komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, në Administratën për të drejtat e njeriut dhe pakicave, Ministrin e kulturës dhe Ministrin e arsimit dhe shkencës.

Dy praktikant shqiptar nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës, nga nëntori punojn në zyrën e trupit Koordinues në Beograd. Sikurse në organet e tjera shtetore në të cilët realizohet projekti për praktikant, edhe trupi Koordinues për praktikantët e vet ka caktuar mentoren e cila do të përkujdeset që gjat periudhës gjashtë mujore do të punoj së bashku me ta në mënyrë që të pasurohen sa më shumë me dituri dhe eksperiencë.

Programin për praktikant financiarisht e ka përkrahur ambasada e Britanis së Madhe, ndërsa e realizon Ministria për të drejtat e njeriut dhe pakicave, administratës shtetore dhe vetqeverisjes lokale në partneritet me misionin e OSBE-së.

• **Bursa për 233 nxënës të shkollave të mesme** – Tre vjet me rradhë trupi Koordinues ndan bursa



nxënësve të shkollave të mesme të tri komunave nga jugu i Sërbisë. 233 nxënës nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, nga trupi koordinues kanë marr bursa me shumë prej 6.000,00 dinarë në muaj, të cilën do ta marrin gjat gjith vitit shkollor. Këtë vit janë ndarë 27 bursa më shumë se vitin e kaluar. Për të gjithë këta trupi Koordinues ka organizuar vizitë njëditore në Beograd, vizitë Parlamentit, ku janë takuar me kryetarin Sllavica Xhukiq-Dejanoviq dhe kryetarin e trupit Koordinues ministrin Millan Markoviq, ndërsa këta i pranoi edhe kryetari i Republikës Sërbisë Boris Tadiq.

„Qëllimi i ndarjes së bursave është arritja e integritetit, paqes dhe stabilitetit në komunat e jugut të Sërbisë“, tha kryetari i trupit Koordinues ministri Millan Markoviq dhe shtoi që qëllimi i Qeverisë së Sërbisë është të vazhdojë ndarjen e bursave edhe vitet e ardhshme.

Secili student nga trupi Koordinues ka marr për dhuratë nga një MP3.

• **Ndarja e mjeteve në konkurs të trupit Koordinues** – Në nëntor trupi Koordinues për her të tretë ka shpallur konkurs për projekte të OJQ-ve. Shuma prej 3.945.082,00 dinarë i është ndarë për realizimin e 10 projekteve të cilët mirren me promovimin e jetës së shëndoshë dhe multietnicitetin nëpërmjet sportit, promovimin e aktiviteteve kulturore tek banorët e moshave të ndryshme që jetojnë në vendbanime rurale larg nga vendbanimet urbane, dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore.

• **Mledhja e Kryesisë së trupit Koordinues** – Të mërkurën më 21 dhjetor është mbajtur mledhja e Kryesisë së trupit Koordinues. Të gjithë antarët e Kryesisë iu është paraqitur raporti mbi punën për vitin 2011, harxhimi i buxhetit për 2011, edhe është prezentuar buxheti për vitin 2012 të cilin e ka miratuar Qeveria e Republikës Sërbisë.

• **Bursistët të cilët studiojnë në Novi Sad vizituan trupin Koordinues** – Njëmbëdhjetë bursistët të cilët studiojnë në Novi Sad, të mërkurën më 21 dhjetor kanë vizituar trupin Koordinues. Bursistët, gjenerata e parë e programit të bursave, kanë folur me drejtoreshën e trupit Koordinues Danijella Nenadiq rreth eksperiencave të deritanishme në Novi Sad. Të gjithë ata kanë arritur të i përshtaten jetesës në një ambient të ri dhe të formojnë shoqëri të re, e poashtu edhe të kalojnë kollokfiomet e para në fakultetet e tyre. Studentët shqiptarë të cilëve gjuha sërbe nuk është gjuhë amtare kanë arritur të përforcojnë gjuhën sërbe që i ndihmon atyre të komunikojnë me kolegët tjerë dhe i mundson atyre të përcjellin ligjeratat dhe kalojnë kollokfiomet. Trupi Koordinues do të mundohet që në vitin 2012 të sigurojë numër edhe më të madh të bursave për të rinjtë nga komuna e Bujanocit dhe Preshevës, të interesuar të studiojnë në fakultetet e Novi Sadit.

Republika e Sërbisë Trupi Koordinues për komunat  
Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë

Tel: 011 21 20 906  
011 21 20 907  
Faks: 011 21 20 909

E-mail: office@kt.gov.rs